V E N D I M
Nr.100, datë 2.3.2001

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.379, DATË 12.6.1998, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.32, DATË 24.3.1978, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, NDRYSHUAR ME VENDIMIN NR.459, DATË 15.8.1994, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PRODHIMIN, SHPËRNDARJEN DHE PËRDORIMIN E ENERGJISË ELEKTRIKE""

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 4 të nenit 18 të ligjit nr.7962, datë 13.7.1995, "Për energjinë elektrike", dhe të ligjit nr.7970, datë 20.7.1995 "Për rregullimin e sektorit të energjisë elektrike", me propozimin e Ministrit të Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Në vendimin nr.379, datë 12.6.1998, të Këshillit të Ministrave, paragrafi i parë ndryshon si vijon:

"KESH sh.a., "SESA Shkodër" sh.a., "Elektriku Vlorë" sh.a. dhe "Elektriku" sh.a. Elbasan, t'i drejtohen Entit Rregullator të Energjisë, për të përcaktuar masën e faturimit mujor të energjisë elektrike, për rastet kur përdoruesit familjarë nuk kanë aparate njehsore (matës), të përdorimit të energjisë elektrike ose kur këto aparate i kanë jashtë kushteve teknike të matjes.".

2. Ngarkohen KESH sh.a., "SESA Shkodër", Sh.a., "Elektriku Vlorë", sh.a. dhe "Elektriku" sh.a. Elbasan, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta